



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 53, datë 24 .12. 2012

**PËR**

**“MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2013-2015 DHE  
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2013”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2 nenit 19, pika 1-8 dhe nenit 32, gërma “dh” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); udhëzimeve të Ministrit të Financave 7/1, datë 29.02.2012 dhe nr.7/3, datë 01.08.2012, për “Përgatitjen e buxhetit vendor”; udhëzimit të Ministrit të Financave nr.8, datë 29.03.2012, për “Procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, shkresën nr.18030 datë 15.11.2012 të Ministrisë së Financave për transfertën e pakushtëzuar të vitit 2013, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2013-2015 si më poshtë vijon.

1.1 Plani i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2013-2015, është në shumat si më poshtë:

<b>Plani i të ardhurave</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>Në lekë 2015</b>
<b>Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore</b>			
– Të ardhura tatimore	5,363,550,000	5,746,950,000	6,021,974,000
– Të ardhura jo tatimore	1,778,681,000	1,844,583,000	1,923,400,000
<b>Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar</b>	937,521,000	1,003,147,000	1,073,368,000
<b>Totali</b>	<b>8,079,752,000</b>	<b>8,594,680,000</b>	<b>9,018,742,000</b>

1.2 Plani i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës Tiranës për periudhën 2013-2015, është në shumat si më poshtë:

<b>Plani i shpenzimeve</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>Në lekë 2015</b>
Shpenzime korrente	5,278,670,000	4,970,303,000	5,100,440,000

Shpenzime kapitale	<b>2,801,082,000</b>	<b>3,624,378,000</b>	<b>3,918,302,000</b>
<b>Totali</b>	<b>8,079,752,000</b>	<b>8,594,680,000</b>	<b>9,018,742,000</b>

2. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2013 si më poshtë:
  - 2.1 Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrave Nr.1 dhe Nr.1/1, pjesë përbërëse të këtij vendimi.
  - 2.2 Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë së Tiranës, Njësive Bashkiake si dhe çdo institucioni dhe ndërmarrje të varësisë sipas pasqyrës Nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - 2.3 Të miratojë detajimin e buxhetit të shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrave Nr.3, Nr.3/1, Nr.3/2, pjesë përbërëse të këtij vendimi.
  - 2.4 Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale sipas programeve si në Pasqyrën Nr.4 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
  - 2.5 Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2013.
  
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Investimeve të Huaja, Drejtoria e Prokurimeve, Njësiti Bashkiake dhe të gjitha Institucionet dhe Ndërmarrjet në varësi të Bashkisë së Tiranës, për zbatimin e këtij vendimi.
  
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**